FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

PREDNIZON

Tableta – 5 mg

(Prednizon acetat)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Prednizon dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Prednizon
3. Si ta merrni Prednizon
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Prednizon
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PREDNIZON DHE PËRSE PËRDORET

Prednizoni është një glukokortikoid që frenon formimin, çlirimin dhe veprimtarinë e mediatorëve endogjenë të inflamacionit, përfshirë prostaglandinat, kininat, histaminën, enzimat lipozomale dhe sistemin e komplementit. Ai përndryshon edhe përgjigjen imunitare të organizmit. Në sistemin hematopoetik shkakton uljen e numrit të limfociteve, eozinofileve dhe bazofileve, kurse rrit numrin e neutrofileve, trombociteve dhe eritrociteve. Antagonizon veprimin e vitaminës D në përthithjen e kalciumit nga aparati tretës (shfaqje e osteoporozës) dhe nxit sekretimin e acidit klorhidrik. Në sistemin nervor qendror vepron si nxitës, duke shkaktuar eufori, psikoza dhe konvulsione.

Prednizon indikohet në: astmë bronkiale; artrit reumatoid; lupus eritematoz sistemik; dermatomiozit; sëmundje të indit lidhor (përjashtuar sklerozën sistemike); poliarterit nodoz; çrregullime inflamatore të lëkurës, përfshirë pemfigus vulgaris, pemfigoidin buloz dhe piodermën gangrenoze; nefrit intersticial akut; kolit ulçeroz; sëmundjen e Crohnit; sarkoidozë; kardit reumatik; anemi hemolitike (autoimune); leuçemi akute e limfatike; limfomë malinje; mielomë të shumëfishtë; purpura trombocitopenike idiopatike; transplantet si imunosupresiv, etj.

2. PËRPARA SE TË MERRNI PREDNIZON

Mos merrni Prednizon në qoftë se:

- jeni alergjik ndaj prednizonit ose ndaj lëndëve ndihmëse të tabletave Prednizon;
- keni një infeksion mykotik sistemik;
- keni imunizim me viruse të gjalla;
- keni tuberkuloz akut.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos i merrni tabletat. Shkoni dhe flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Prednizon

Njoftoni mjekun tuaj:

- në qoftë se jeni shtatzënë, po planifikoni të ngeleni shtatzënë, ose jeni duke ushqyer foshnjen me gji;
- në qoftë se jeni duke marrë barna me ose pa recetë, preparate bimore, ose shtesa dietetike;
- në qoftë se keni alergji nga barna, ushqime, ose lëndë të tjera;
- në qoftë se keni planifikuar të bëni një vaksinë me virus të gjallë (p.sh, lija);
- në qoftë se keni një tiroide hipoaktive, probleme të veshkave ose mëlçisë, diabet ose kolit ulçeroz;
- në qoftë se keni probleme të zemrës, ezofagit, gastrit, obstruksion ose perforacion të stomakut, ose një ulcerë;
- në qoftë se keni patur probleme mendore, si depresion;
- në qoftë se keni një infeksion herpetik në sy ose ndonjë tip tjetër infeksioni (bakterial, mykotik, ose viral); keni ose keni patur së fundmi tuberkuloz (TB) ose teste pozitive për TB, fruth, ose li të dhenve;
- në qoftë se vuani nga sklerodermia (e njohur edhe si skleroza sistemike, një çrregullim autoimun) sepse dozat ditore prej 15 mg ose më shumë mund të rrisin riskun për një komplikacion serioz të quajtur kriza renale sklerodermike. Shenjat e saj përfshijnë presion të rritur të gjakut dhe prodhim të ulur të urinës. Mjeku mund t'ju këshillojë të kontrolloni rregullisht presionin e gjakut dhe urinën.

Fëmijët

Duke qenë se trajtimi me Prednizon mund të frenojë rritjen tek fëmijët, ky bar duhet përdorur vetëm nëse mjeku e sheh të nevojshme dhe rritja e fëmijës duhet monitoruar vazhdimisht.

Efektet e keqpërdorimit si agjent dopingu

Përdorimi i Prednizon mund të shkaktojë efekte pozitive dopingu.
Për më tepër, përdorimi i Prednizon si agjent dopingu mund të përbëjë rrezik të madh për shëndetin.

Marrja e barnave të tjera

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë.
Ka shumë barna që mund të ndërveprojnë me steroidet.
Më poshtë është një listë e pjesshme e këtyre barnave:

- aspirina (e marrë në bazë ditore ose në doza të larta);
- diuretikët;
- holluesit e gjakut, si varfarina;
- ciklosporina;
- insulina ose antidiabetikët oralë;
- antibiotikët si rifampin, ose troleandomicin; ose barnat antiepileptikë si fenitoin ose fenobarbital.

Kjo listë nuk është e plotë dhe mund të ketë barna të tjera që ndërveprojnë me Prednizon. Njoftoni mjekun tuaj për të gjitha barnat me dhe pa recetë që ju përdorni. Këtu përfshihen vitaminat, mineralet, produktet bimore, dhe barnat e përshkruara nga mjekë të tjerë. Mos filloni përdorimin e një mjekimi të ri pa njoftuar fillimisht mjekun tuaj.

Marrja e Prednizon me ushqim dhe pije

Shmangni përdorimin e alkoolit gjatë terapisë. Merreni barin me ushqim.

Shtatzënia

Ky mjekim mund të jetë i dëmshëm për fëmijën e palindur. Njoftoni mjekun tuaj nëse jeni shtatzënë ose planifikoni të ngeleni shtatzënë gjatë mjekimit.

Ushqyerja me gji

Prednizon mund të kalojë në qumështin e gjirit dhe të dëmtojë foshnjen që ushqehet me gji. Mos e përdorni këtë mjekim pa njoftuar fillimisht mjekun që jeni duke ushqyer një foshnje me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Ky bar ka një ndikim të vogël në aftësinë e drejtimit të automjetit dhe përdorimit të makinerive.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e tabletave Prednizon

Bari përmban laktozë. Në qoftë se keni intolerancë ndaj disa sheqernave, flisni me mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI PREDNIZON

Merreni këtë bar ashtu siç ju është përshkruar. Mos e merrni në doza më të mëdha, ose për një kohë më të gjatë se sa rekomandimi i mjekut tuaj.
Mjeku juaj mundet ta ndryshojë dozën sipas rastit për tu siguruar që ju të merrni rezultatin më të mirë të mjekimit.
Prednizon duhet të merret nga goja, me ushqim për të evituar dhimbjet e stomakut.
Doza e Prednizon duhet të individualizohet në bazë të gravitetit të sëmundjes dhe përgjigjes së pacientit.
Të rriturit: Doza varet nga sëmundja, shkalla e rëndimit të saj dhe përgjigjja klinike e përftuar.
Mjekimi afatshkurtër: 20 – 30 mg në ditë, për pak ditë; doza ditore pastaj ulet me 2.5 ose 5 mg, çdo 2 deri në 5 ditë, në varësi nga përgjigjja.
Artriti reumatoid: 7.5 deri në 10 mg në ditë. Doza duhet të ulet deri në nivelin më të ulët që siguron një përgjigjje klinike të përshtatshme.
Për shumicën e sëmundjeve të tjera përdoren 10 deri në 100 mg në ditë për 1 deri në 3 javë; pastaj doza ulet deri në dozën e efektshme më të ulët.
Fëmijët: Mund të përdoren fraksione të dozës së të rriturve (p.sh. 75 % për 12-vjeçarin, 50 % për 7-vjeçarin dhe 25 % për 1-vjeçarin), por duhen patur parasysh edhe faktorët klinikë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Prednizon

Në qoftë se keni marrë më shumë Prednizon se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Një dozë e vetme e lartë e Prednizon nuk pritet që të shkaktojë simptoma kërcënuese për jetën.
Megjithatë, përdorimi për kohë të gjatë i dozave të larta me steroide mund të çojë në simptoma si: hollimi i lëkurës, mavijosje, ndryshime në formën ose vendndodhjen e dhjamit në trup (veçanërisht në fytyrë, qafë, shpinë dhe bel), shtim të akneve ose të qimeve në fytyrë, probleme menstruale, impotencë, ose humbje të interesit seksual.

Në qoftë se keni harruar të merrni Prednizon

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

Në qoftë se ndaloni marrjen e Prednizon

Mos e ndaloni menjëherë marrjen e Prednizon, sepse mund t'ju shfaqen simptoma të pakëndshme të abstinencës. Flisni me mjekun tuaj për shmangien e këtyre simptomave gjatë ndërprerjes së terapisë me Prednizon.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Prednizon mund të shkaktojë efekte anësore në disa pacientë.
Merrni ndihmë urgjente mjekësore në qoftë se keni ndonjë prej shenjave të reaksionit alergjik në vijim: vështirësi në frymëmarrje; enjtje të fytyrës, buzëve, gjuhës, ose grykës.
Informoni menjëherë mjekun tuaj në qoftë se keni ndonjë prej këtyre efekteve serioze anësore:

- probleme me shikimin;
- enjtje, rritje të shpejtë në peshë, ndjesi që nuk mbusheni me frymë;
- depresion të rëndë, mendime ose sjellje të pazakontë, krizë (konvulsione);
- feçe me gjak ose të errëta, kollë me gjak;
- pankreatit (dhimbje të fortë në pjesën e sipërme të stomakut që përhapet në shpinën tuaj, nauze dhe të vjella, rrahje të shpejta të zemrës);
- nivele të ulëta të kaliumit (konfuzion, rrahje të çrregullta zemre, etje ekstreme, urinim të shtuar, parehati të këmbëve, dobësi muskulare ose vështirësi në ecje);
- presion të lartë të gjakut (dhimbje të fortë koke, shikim të turbullt, gumëzhimë në vesh, ankth, konfuzion, dhimbje të kraharorit, ndjesi që nuk mbusheni me frymë, rrahje të çrregullta zemre, krizë);
- krizë renale sklerodermike në pacientët që vuajnë nga sklerodermia (çrregullim autoimun) (frekuencë e panjohur). Shenjat e saj përfshijnë presion të rritur të gjakut dhe prodhim të ulur të urinës.

Efekte anësore më pak serioze përfshijnë:

- probleme me gjumin (pagjumësi), ndryshime të sjelljes;
- akne, lëkurë të thatë, hollim të lëkurës, mavijosje ose çngjyrosje;
- shërim të ngadaltë të plagës;
- djersitje të shtuar;
- dhimbje koke, marramendje;
- nauze, dhimbje të stomakut, fryrje;
- ndryshime në formën ose vendndodhjen e dhjamit në trup (veçanërisht në krahë, këmbë, fytyrë, qafë, gjoks, dhe bel).

Kjo nuk është një listë e plotë e efekteve anësore që mund të ndodhin. Informoni mjekun tuaj për ndonjë efekt anësor të pazakontë ose të bezdisshëm.

5. SI TA RUANI PREDNIZON

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Prednizon pas datës së skadimit, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmbajnë tabletat Prednizon 5 mg

Lënda aktive është prednizon acetat.
Çdo tabletë përmban 5 mg prednizon acetat.
Lëndët ndihmëse janë laktozë monohidrat, amidon i prexhelatinizuar, talk, laurilsulfat natriumi, glikolat natriumi i amidonit.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 60 tableta.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.